

KANINA DHE VLORA

nga udhëpërshkrimi (*Sejihatnameja*) i Evlija Çelebiut

Robert Elsie

Në nëntor të vitit 1670, udhëtari turk, Evlija Çelebi, vazhdoi rrugën e tij në Shqipërinë e Jugut. Pas vizitave në Gjirokastrë dhe në ai erdhi në kalanë e Kaninës dhe në qytetin e Vlorës, që i përshkruan me një interes të veçantë.

Pasi i lamë lamtumirën Beut, vijua udhëtimin kah jugu në një luginë, duke kaluar nëpër Xhyherinë e Qishbardhë e nëpër fshatra të tjerë të begatë, dhe për ---- orë mbërritëm në kalanë hijerëndë e të pashoqe të Kanje-s (*Kanina*). Ajo është ndërtuar në fillim nga mbreti i Spanjës. Emri i saj në italisht është Pokronard. Në vitin ---- u pushtua nga Koxha Mahmud Pasha, vezir i Sulltan Mehmed Pushtuesit. Më pas u mor nga venedikasit. Në vitin ----, gjatë sundimit të Bajazidit II të Shenjtit, Gazi Kyçyk Evrenos Beu e rrethoi kalanë dhe zuri ta bombardojë. Kur të pafetë brenda u dorëzuan dhe kërkuan mëshirë, duke pyetur “Ç’do të hamë?”, Kyçyk Evrenos Beu u përgjigj *Kan je* (“Ha gjak”), e kështu i mbeti emri kalasë. Ajo është tani në kufirin e sanxhakut të Vlorës. Prej këndeje mund të shihen edhe shpendët, pula e pata, në kalanë e Vlorës, e cila është poshtë pranë detit nga perëndimi.

Kanina është një kala shumë e lartë me kryet në qiell. Ka një strukturë të fortë mbi një kep malor toke dhe mbi një shkëmb shpanti. Nga trajta është triëndëshe dhe perimetrin e ka 3.000 hapa. Hendeqe nuk ka në asnjërën anë, qoftë edhe një hap të gjerë, sepse as nuk është nevoja, nga që rretheqark ka vetëm shkrepë shkëmborë dhe hone. Brenda gjenden 300 shtëpi prej guri me çati me tjegulla. Këtu është edhe xhamia e Sulltan Mehmedit II, e cila ka një çati me tjegulla dhe një minare të hijshme. Pranë xhamisë janë sarajet e Gazi Sinan Pashës. Nga kalaja e Kaninës mund të shihet fusha e Vlorës, Deti i Korfuzit (Deti Jon), ishulli i Korfuzit 150 milje larg, si dhe gjiret e Vlorës, Dukatit dhe Progonatit, e po ashtu edhe kalatë e ---- e të ---- anës bregut të detit. Është kala aq e lartë, sa që të duket se e ke tërë botën nën këmbët e tua.

Kalaja e Kaninës ka tri porta. E para sheh nga juglindja dhe e lidh kalanë me qytetin jashtë mureve nga ajo anë. E dyta sheh nga veriu dhe del në rrugën që zbret për në Vlorë. E treta sheh nga jugu dhe del në një vendbanim të vogël jashtë mureve (*varosh*). Afër kësaj porte është citadela, e cila ka një portë që sheh nga lindja e që lidhet me kalanë kryesore. Citadela ka vetëm 20 shtëpi, të ndërtuara në stil të vjetër, me çati me tjegulla. Ajo ka edhe depo për drithë e municione dhe sterna për ujë.

Jashtë dhe poshtë murit të citadelës janë katër topa, që shohin kah limani i Vlorës, të tillë që nuk ka perandor t’i ketë patur e as post kufitar t’i ketë përdorur. Njëri prej topave është aq i madh, sa që dimër e verë shërben si banesë për një të pastrehë, ku ai mban edhe jorganin, dyshekun, tiganin dhe gunën. Në të vërtetë, një farë bamirësi e ndihua për të bërë te tyta e topit një derë, të cilën fakiri mund ta hapë e ta mbyllë, tamam si me qenë derë shtëpie. Ai e ka si dhomë banimi dhe bie për të fjetur e ngrihet nga gjumi brenda topit!

Sipër portës veriore ka një mbishkrim me shkronja *xheli* mbi një pllakë kënd-drejtë prej mermeri të bardhë, ku na tregohet data kur Sulltan Sulejmani e ka ndrequr dhe e ka rindërtuar kalanë. Rrugët në kala shkojnë vetëm përpjetë e tatëpjetë. Brenda mureve nuk ka pazare, hane, hamame ose godina publike, kurse në qytetin jashtë mureve (*varosh*) në jug të kalasë gjenden 300 shtëpi prej guri me çati me tjegulla dhe me hardhi e kopshte, të gjitha hipur njëra mbi tjetrën. Edhe këtu nuk ka gjurmë pazari. Është vetëm xhamia e bollshme e Sinan Pashës me minaren e saj të lartë e të hijshme. Këtu është edhe teqeja e Haxhi Bektash Veliut, gjithashtu bamirësi e Sinan Pashës. Kjo teqe është me emër në mbarë Turqinë,

Arabinë dhe Persinë. Këtu hasen shumë idhtarë të praktikave mistike dhe të jetës askete të dervishëve. Mes tyre ka djem të rinj tërheqës. Vizitorëve, shtegtarëve dhe atyre që vijnë këtu për t'u falur u nxirret haje e bollshme nga kuzhina dhe qilari i teqesë, sepse të sajat janë të gjitha malet, vreshtat dhe pemishtet rrethëqark. Pranë teqes është varrosur bamirësi dhurues i saj, Gazi Sinan Pasha, së bashku me njerëzit e familjes dhe shpurës së tij, në një tyrbe me një kube të lartë Zoti i mëshiroftë shpirtrat e tyre! Me pak fjalë, ajo është një teqe e pasur dhe e përmendur, dhe nuk gjej fjalë për ta përshkruar.

Kalaja e Kaninës ruhet prej 400 trupash garnizoni dhe prej dizdarit, të cilët i marrin pagat nga emini i Vlorës. Gjysma e ushtarëve të kësaj kalaje qenë urdhëruar të niseshin në mbrojtje të Manias. Sa për ne, ne dolëm nga porta veriore dhe zbritëm tatëpjetë malit, duke soditur pamjet rrethëqark për dy orë me radhë, herë kaluar e herë më këmbë.

Limani dhe kalaja e Vlorës. Vlora është themeluar në vitin ---- nga Sulltan Sulejmani, i cili urdhëroi të ngrihej një kala e vogël në trajtën e një oborri të rrethuar (*avlu*) me pamje nga deti, me qëllim që Gjiri i Vlorës të mbrohej nga sulmet e venedikasve, dhe kështu, me përfundimin e ndërtimit, mori emrin Avluja. Ky emër figuron në Zyrat e Regjistratit Perandorak me emrin sanxhaku Avlonia. Vlora është kryeqendër e këtij sanxhaku sipas ndarjes së vjetër administrative, kurse Berati u bë kryeqendër me që ndodhet në mesin e vilajetit. Kalaja e Vlorës është ngritur mbi një gjuhë rëre të ulët në hyrje të Gjirit të Vlorës e të Gjirit të Dukatit. Është oktagonale nga trajta dhe shumë e fortë e e lidhur, një mur i madh i vërtetë i Sulltan Sulejmanit. Njerëzit thonë se osmanët nuk dijnë të ndërtojnë kala, por ai që nuk e ka parë kalanë e Szeged-it në vijën kufitare të Erlau-t, kalanë e Bender-it në brigjet e Dniestrit në vijën Oçakov, dhe këtë kala të Vlorës, nuk mund ta kuptojë sa mjeshtërore mund të jenë veprat ndërtimore osmane.

Muret e kalasë së Vlorës janë 20 kut të larta dhe 10 kut të trasha në të gjitha anët. Në të 8 qoshet e mureve të kalasë janë 8 pika të fortifikuara, secila si muri i Gogut e Magogut, dhe secila me 7 bateri topash të mëdhenj me qitje të largët. Përveç këtyre, brenda portave të hekurta në nivelin e detit janë 47 bateri të tjera topash, me tytat në drejtim të Gjirit e të ngarkuar mbi karro si me qenë dragonj shtatë-krerësh. Ata janë të mbuluar me cohë të kuqe tendash dhe janë aq të mëdhenj, sa në tytat e tyre mund të hyjë njeriu. Topat janë në gatishmëri për qitje në çdo kohë, kurse njerëzit, që i ruajnë, rrijnë shtrirë pranë tyre ditë e natë.

Nga njëri qosh deri tek tjetri i të 8 qosheve është një largësi prej 120 hapash, kështuqë, po t'i mbledhim, perimetri i përgjithshëm i kalasë së Vlorës del 900 [sic] hapa. Brenda në kala është xhamia e Sulltan Sulejmanit, kurse mu në qendër është kulla e Sulejman Shahut. Ajo është një kullë shumë e lartë, e punuar bukur, 7 kate e lartë, dhe është ndërtuar me gurë të gdhendur, me një kube konike të mbuluar me plumb e me një shtizë të praruar në majë. Kjo mund të merret si citadela e kalasë së Vlorës. Është kullë shumë e rëndë dhe e lartë, ashtu si Kulla e Kallamarias në Selanik, sepse që të dyja janë ndërtuar nga Sinani i madh, arkitekti i Sulltan Sulejmanit. Kulla banohet vetëm nga dizdari dhe është e mbushur shtresë pas shtrese me municion dhe pajisje e furnizime të tjera ushtarake.

Brenda në kalanë e jashtme janë rreth 300 shtëpi qerpiçi të vjetëruara, të ulëta e të ngushta, me çati me tjegulla, por pa pjergulla, bahçe e oborre. Edhe pse rrugët kryesore publike janë të gjera, nuk ka gjë tjetër veç një pazari: as hane, as hamame, as godina të tjera publike. Kalaja ka dy porta, kurse hapësira ndërmjet tyre është e mbushur plot e përplot me municione llojesh të ndryshme. Ruhet nga roje e postë-roje ditë e natë. Njëra portë sheh nga lindja, kurse tjetra nga perëndimi. Kalaja është tërësisht e rrethuar nga një hendek 50 hapash të gjerë në të gjitha anët dhe e mbushur me ujë deti, i cili, megjithatë është kthyer në ujë të ndenjtur. Secila nga portat ka një urë lëvizëse përpara, e cila natën ngrihet dhe lidhet e sigurohet me zinxhirë për të krijuar një pengesë mbrojtëse. Ka 500 topa, të mëdhenj e të vegjël. Në kullë banojnë dizdari, 12 oficerë dhe 400 trupa garnizoni. Gjysma e këtyre ushtarëve qenë urdhëruar të shkonin për të mbrojtur vilajetin e Manias, sipas dekretit

perandorak. Këtu janë edhe qehajai i spahive, komandanti i jeniçerëve, një kadi me nivel page 300 akçesh, që mbulon 105 fshatrat e begata të krahinës, një inspektor finance, një tagrambledhës, një inspektor dogane, një nëpunës i vjeljes së taksës për frymë, një kryearkitekt, një oficer i marinës, komandanti i limanit dhe qehajai i qytetit.

Nga lindja e kalasë dhe disi mbi të gjendet një shpat i mbuluar me ullishta. Të gjitha kodrinat dhe fushat e kësaj krahine janë të mbuluara me drurë frutorë, vreshta dhe ullishta. Në këtë pikë të lartë gjendet varri i ---- Baba Sulltanit dhe i disa dervishëve bektashi.

Sheshet e faljes. Ndërmjet kalasë dhe qytetit jashtë mureve gjendet një lëndinë e gjerë, ku njerëzit kryejnë ritin e faljes, e që mund të marrë deri në 2.000 vetë. Nga kalaja deri te qyteti jashtë mureve kjo lëndinë shtrihet në 1.000 hapa gjatësi.

Qyteti i Vlorës jashtë mureve të kalasë. Qyteti jashtë mureve është bajagi i ndarë nga kalaja. Ai shtrihet në një fushë të gjelbëruar, të mbushur me vreshta e kopshtije, me trëndafila, limonë, portokaj, ullinj, shegë e fiq, si ato të kopshteve përrallore të Irem-it. Qyteti ka 1.000 shtëpi të bukura guri një- e dy katëshe, të mbuluara me çati me tjegulla.

Janë ---- mëhalla, ndër to ajo e xhamisë Hynqar, e Memxhi-zadesë, e lëkurëpunuesve, e Hysejn Agës, e gjykatës, dhe e pazarit.

Gjithsej ka ---- faltore. Ndër to është xhamia e bukur e Sulltan Sulejmanit [Muradie] me një kube guri të gdhendur, me mbulesë plumbi, e me një minare të rënë. Përmbi derën e *kibles* është mbishkrimi i mëposhtëm:

“I pari, Jakupi, shehu besnik i fesë,
E ktheu shtëpinë e tij në faltore (mesxhid), për hir të Zotit.
I dyti Sulltan Sulejmani i Kohës,
E ktheu në xhami të madhe për të falur xhumanë i lumtë!
Hasbiu e shkroi kronogramin për këtë tempull:
Gjettë dritën e së Vërtetës, xhamia e atyre që kanë vajtur pranë Zotit.
Viti 949/1542.”

Kjo xhami është vend devocioni të thellë.

Pastaj vjen xhamia e bukur e Memxhi-zadesë, me një grigjë të madhe besimtarësh për t’u falur: është e mbuluar me çati me tjegulla dhe ka një minare guri të latuar.

Xhamia e Hysejn Agait pranë mëhallës së lëkurëpunuesve: godinë e re, e ndërtuar mirë, e mbuluar me tjegulla, me një minare të hijshme guri të latuar.

Xhamia e kalasë: e përshkruar më sipër.

Ka edhe 5 xhami mëhallash në të 5 mëhallat e sipërpërmendura.

Ka 3 medrese: e Jakub Efendiut, e Memxhi-zadesë dhe e Hysejn Aga-zadesë.

Ka 5 mejtepe.

Ka 3 kuvende dervishësh, ndër to teqeja halvetie e Jakub Efendiut me qindra dervishë ithtarë, këmbëzbathur e kokëjashtë, me xhybe leshi; si dhe teqeja e përmendur më sipër e Kusum (Kuzgun) Babait mbi një shpat, që e sheh kalanë nga lart, e ngritur mes vreshtash, si në kopshtet përrallore të Irem-it.

Ka 1 hamam të vogël godinë e mrekullueshme përballë së cilës është godina e gjykatës së sheriatit, e ndërtuar nga Axhem Mehmet Efendi, kur ishte gjykatës i qytetit.

Ka një pazar të bukur me gjithsej 417 dyqane, ku mund të gjenden të gjitha llojet e zejeve e të mallrave. Nuk ka bezistan, por këtu mund të gjesht të gjitha llojet e pëlhurave të holla dhe stofrave të shtrenjtë, sepse ai është *scala* ose skelë ku bëjnë tregti venedikasit. Ka 4 hane dhe 8 çesme, prej të cilave më në zë është ajo e Ilias Pashës afër teqesë së Jakub Efendiut, me këtë mbishkrim:

“Në ditën e tubimit, gjeta datën e Ilias Pashës,
Prandaj shpalla kronogramin e tij: “Dhe ai është më i miri shërbëtor i Zotit”.

Të gjitha çesmat e tjera nuk punojnë më, prandaj banorët e qytetit kanë nevoja të ngutshme për ujë. Burime ujore ka, por vijat janë prishur me kalimin e kohës. Me pak përpjekje ndonjë bamirës mund ta përmirësojë gjendjen, të ngushëllojë shpirtin e dëshmorëve të Qerbelasë dhe të rikujtojë veprën e dymbëdhjetë imamëve. Në gjendjen e tanishme, të gjithë në këtë qytet të kamur e të vobektë, të mëdhenj e të vegjël duhet të marrin rrugën për të dalë gjysëm ore larg te vreshtat në lindje të qytetit për një gllënjë ujë. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, gjithçka tjetër gjendet me bollëk. Në pemishtet dhe vreshtat e tyre gjenden lloj-lloj frutash me bollëk të madh.

Hajet e pijet më të rëndësishme. Në këtë gji deti gjendet krapë, toni i vogël, skumbria, barbutja dhe levreku i vogël, si dhe veza e peshkut, më e mirë se ajo që kemi në Turqi. Gjendet me sasi të mëdha vera e quajtur *rejhaní*, si dhe limonët, portokajtë, ullinjë dhe rrushi. Në fshatrat e Dukatit kultivojnë bimë me rrënjë boje të kuqe dhe ravenë të Anadollit, të cilat mjekët i mbledhin dhe i eksportojnë në Europë.

Nuk ka serë më të kulluar e më të këndshme se ajo e Vlorës. Nëse hidhet serë e zier në një kupë të zbrazët, e pastaj ajo tundet mirë e mirë dhe nga kjo kupë pihet ujë, shërohen sëmundje të tilla si kolera, këlbaza, krimbat e zorrëve, etj., dhe pastrohen të përbrendshmet e trupit.

Gurë mulliri, me pore si sfungjer, nxirren nga guroret e shkëmbinjve poshtë kalasë së epërme të Kaninës. Këta gurë mulliri eksportohen në Europën Perëndimore. Këta janë më të mirë se ata që prodhohen në ishullin Milos të Egjeut.

Rrugës që të shpie në vreshtat ndodhen një minierë gjipsi, një minierë hekuri, dhe lloj-lloj minierash të tjera. Kjo krahinë e Vlorës, vërtet, është minierë mbi minierat, aq shumë ka.

Anës bregut të detit gjenden dajlane të panumërt, të tipit që mund të gjenden gjetiu vetëm afër Anadollguz-it [Mesolongji].

Me pak fjalë, sanxhaku i Vlorës është një Egjipt i panjohur me mundësi për të qenë burim pasurie të madhe për sundimtarin e vet. Mjalti i bardhë i kulluar, që prodhohet këtu, me erën e mirë të myshkut dhe ambrës gri, është më i mirë se ai që bëhet në Athinë dhe në ishullin e Kretës. Po të përzihet një filxhan mjaltë me njëzet filxhanë ujë del një sherbet a pelte e shijshme.

Limani i madh i Vlorës. Gjendet ndërmjet kalasë së Vlorës dhe kalasë së Jengjeçit dhe mund të mbajë 1.000 anije. Është thënë se Sulltan Sulejmani e ndërtoi kalanë e Vlorës për të mbrojtur anijet e bregëzuara në këtë liman. Më pas, këtu ai bregëzoi flotën perandorake dhe pikërisht prej këndeje sulmoi ishullin e Korfuzit, të mbajtur nga Venediku. Galionë transporti të mëdhenj nuk mund të hyjnë në këtë liman, por mund të hedhin spirancën në det gjysëm milje larg.

Ndërmjet qytetit të Vlorës dhe ujrave të detit është *fshati i Zvërnecit*, me 150 shtëpi të pafeshë e me një kishë të madhe të mbajtur mirë. Të gjithë këta të krishterë të prapë jetojnë me peshkim e me nxjerrjen e kripës. Kriporja e këtushme është koncesion i pavarur (emanet): të gjithë të pafetë janë të përjashtuar nga taksat e zakonshme dhe, në vend të tyre, paguajnë vetëm taksën e nxjerrjes së kripës. Kjo kripë, shumë e bardhë dhe e shijshme, ngarkohet në qindra anije dhe eksportohet në Europë.

Në perëndim të këtij fshati, mbi një kep 1.000 hapa larg bregut të detit, ndodhet *kalaja e Jengjeçit*. Sot ajo është rrënojë e mbetur shkret me një liman të madh. Gedik Ahmed Pasha pjesërisht e shkatërroi këtë kala dhe kullat në grykë të limanit, kur i pushtoi. Gurët e mbetur u përdorën për të ndërtuar kalanë e Vlorës gjatë sundimit të Sulltan Sulejmanit. Në të katër qoshet e limanit të Jengjeçit ka dajlane peshkimi.

Në perëndim të limanit të Jengjeçit, 18 milje nga bregu, ndodhet *ishulli i Sazanit*. Çdo vit, flota e të pafeve venedikas e kalon dimrin në këtë ishull duke vajosur e lyer anijet. Më pas, çfarëdo drejtimi të marrë, ajo nisat prej këndeje. Në jug të kalasë së Vlorës është një vend

për dalje në det i quajtur Kara Burun (Kepi i Zi). Nga ana e juglindjes është krahina e Dukatit me 100 fshatra shqiptare të pashtuara e rebele. Banorët janë të pafé të zinj, me koka të zeza e qylafë të zinj, por, po i cilësive të pafé, të vrasin. Përveç kësaj, ata çdo vit u venë në ndihmë të pafeve të Kretës. Ata janë ndër luftëtarët më trima mes shqiptarëve. Megjithatë, vlonjatët e qytetit nuk janë luftëtarë më pak trima e sypatrembur dhe, me 10 fregatat e tyre, ata janë në gjendje të mbrojnë kalatë bregdetare kundër të gjithë të pafeve të Europës. Në këtë kohë, sigurisht, gjysma e garnizoneve të këtyre kalave kanë shkuar me këto fregata për të mbrojtur Manian.

Vlora ka klimë të butë, por nuk ka ujë të mirë, sepse banorët përdorin ujë pusi. Megjithatë, falë Zotit, djemtë e vajzat i ka tërheqës. Mirëpo, djelmoshat i ka të gjithë kokëkrisur e rebelë. Ata mbajnë rroba të shkurtra të ngushta, sikundër e kanë zakon në mbarë Arqipelagun e Mesdheut, me pulpët zhveshur, me fes në kokë, me këpucë të zeza çerkeze në këmbë, dhe rrobë të bardhë si të beduinëve hedhur pas shpine. Ata janë trima gjithmonë të gatshëm për luftë. Shumë nga këta trima duken si dervishët kalenderë: pa këmishë, këmbëzbathur, kokëjashtë, me shenja damke në kokë e me të prera në gjokset e çveshur, e me shpirtin gjithmonë të ndezur. Kur ulen apo ngrihen më këmbë, ose sa herë që bëjnë diçka, ata thërrasin, “Ja Muhamed, ja Ali!” Ata i janë përkushtuar familjes së Profetit dhe të gjithë dijnë të lexojnë persisht. Kanë fytyrë kuqaloshë dhe janë me natyrë të fuqishme e të gjallë. I faltë Zoti, sepse janë shpirt njeriu.

[Published in / Botuar në: *Albanica Ekskluzive: revistë mujore për dije e kulturë*, Prishtina, 68, May 2007, p. 82-85]